

NJË VËSHTRIM EKONOMIKO - TEKNIK NË BIZNESET E INDUSTRIË SË DRURIT

ARBEN BOÇARI, LEONIDHA PERI
Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë ,ALBANIA
bbocari@yahoo.com

AKTET V, 3: 515-520, 2012

PERMBLEDHJE

Përpunimi i drurit ka qenë dhe mbetet një nga industritë më të vjetra në Shqipëri. Transformimi i Shqipërisë drejt një ekonomie të tregut të lire e bëri kërkesë imediate studimin e sektorit të përpunim drurit në pikpamje ekonomike. Për këtë qëllimi u ndërmor një anketim mbi bazën e një pyetësori të strukturuar me subjektet e biznesit të kësaj industrie. Anketimi përfshin rrethet Durrës, Skrapar, Kolonjë, Korçë Berat, Devoll, Lezhë, Mat, Dibër, Bulqizë, Lushnje, Sarandë, Librazhd, Tiranë, Kukës dhe Krujë me një numur total prej 49 subjekesh ekonomike, drejtuesit e të cilëve u anketuan "face-to-face" përmes intervistave direkte. Objektivi kryesor është evidetimi i problemeve ekonomike e teknike të këtyre subjekteve si dhe i perceptimeve të tyre në lidhje me tendencat e zhvillimeve në këtë industri në një të ardhme të afërt.

Fjalë kyçe: përpunim druri, anketim, marketing, kosto, konkurrencë

SUMMARY

The Wood industry has been is always going to be one of the old industries in Albania. The transformation of Albania towards a market economy has identified the need of studies and surveys in this industry from economic point of view. For this purpose is carried such a survey based on a questionnaire involving the small business enterprises operating this business. The survey is carried in the districts of Durrës, Skrapar, Kolonjë, Korçë Berat, Devoll, Lezhë, Mat, Dibër, Bulqizë, Lushnje, Sarandë, Librazhd, Tiranë, Kukës dhe Krujë, including a number of 49 small enterprises. The managers of these businesses are asked through the direct interviewing process. The main objective is the identification of the economic problems and the tendency of these problems in a short term perspective.

Key words: wood processing, survey, marketing, cost, competition

Hyrje

Ndryshimet politiko-ekonomike që ndodhën në Shqipëri në 10-vjeçarin e fundit të shek.XX u pasqyruan edhe në industrinë e drurit. Kjo industri kishte përbere deri në këtë periudhë një nga degët e rëndësishme të ekonomisë shqiptare me rreth 25000 të punësuar (FAO, 1992).

Deri në vitin 1996 (BSPID, 1996) shumica e ndërmarrjeve të kësaj industrie u privatizuan dhe sot praktikisht janë ne aktivitet vetëm subjekte private si në industrinë e përpunimit parësor ashtu dhe në atë të përpunimit dytësor.

Informacioni që disponohet sot mbi këtë industri është i vogël, fakt ky që ka motivuar dhe

ndërmarrjen e këtij studimi. Objektivi kryesor është një veshtrim për aspekte të rëndësishme tekniko-ekonomike siç janë kapacitet prodhuese, teknologjitë e instaluara, numri i të punësuarve, kualifikimi i tyre, problemet teknike që hasen, si dhe aspekte të marketingut dhe perceptimit të ecurisë së biznesit në të ardhmen nga subjektet.

Metodologjia e përdorur

Të dhënat e nevojshme për studimin u morën përmes metodës së anketimit të subjekteve të industrisë së drurit të zgjedhur rastësisht në 18 rrethe të vendit.

Anketimi i pronarëve apo administratorëve të subjekteve të përzgjedhura u krye bazuar mbi një pyetësor të strukturuar tërësisht, i cili më parë u testua për të parë problematikën dhe bërë korigjimet e nevojshme.

Çdo intervistë zgjati për rreth 1,5 deri në dy orë dhe të dhënat e mbledhura u hodhën në një database dhe u përpunuan në këndveshtrim deskriptiv. U anketuan 49 subjekte të zgjedhur rastësisht në vendin ku ato zhvillojnë aktivitetin.

Analiza ka një fokus deskriptiv të aspekteve më të rëndësishme të këtyre subjekteve si kapacitet prodhuese, teknologjitë e instaluara, numri i të punësuarve, kualifikimi i tyre, problemet teknike që hasen si dhe aspekte të marketingut dhe perceptimit të ecurisë së biznesit në të ardhmen nga subjektet.

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Forma ligjore e mëparshme (ndërmarje ekonomike shtetërore) pësoi ndryshimin e natyrshëm në forma ligjore të përshtatshme për ekonominë e tregut të pasviteve '90 : Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) , shoqëri anonime (Sh.A.), dhe shoqëri me kapital të përbashkët. Ndërmarjet shtetërore të përpunimit drurit u shndruan në subjekte ekonomike të inisiativës private. Punonjësit shqiptarë ishin mjaft të varfër, prandaj kjo reflektohet edhe në natyrën e formës ligjore të subjekteve ekonomike të pasviteve 90. Rreth 94% e tyre janë subjekte ekonomike SH.P.K. , 4% janë Sh.A. dhe 2% janë shoqëri me kapital të përbashkët.

Forma ligjore e subjekteve ekonomike	Numri subjekteve
SH.P.K.	46
Sh.A.	2
Shoqëri me kapital të përbashkët	1

Industria e përpunimit drurit përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh. Në klasifikimin e subjekteve ekonomike sipas aktivitetit (grafiku1) bie në sy se 68% e subjekteve kryesisht merren me prodhim mobiljesh shtëpiake. Shqipëria ka qenë një vend me sipërfaqe të mëdha pyjore. Kjo ka ndikuar që rreth 18% e subjekteve ekonomike të përpunimit drurit të prodhojnë lëndë të sharruar dhe elemente druri. Subjektet ekonomike që prodhojnë dyer e dritare janë rreth 10% , ndërsa subjekte ekonomike që prodhojnë panele druri janë shumë pak, rreth 2% .

Siç shihet nga grafiku vetëm 20 % e subjekteve të anketuara kanë si aktivitet kryesor përpunimin parësor të drurit. Pjesa dërmuese e subjekteve realizojnë përpunimin dytësor të drurit ku aktiviteti më i rëndësishëm është prodhimi i mobiljeve të ndryshme. Në ecurinë e kohës numri i subjekteve që merren me përpunimin parësor të drurit vjen në ulje sepse sigurimi i lëndës së parë nga burimet pyjore të vendit po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Gjithashtu edhe cilësia e lëndës së drurit nga këto pyje nuk është në nivelet që kërkon prodhimi modern i përpunimit të lëndës së drurit.


Nr. Bizneseve	Punonjës gjithsej	Punonjës të kualifikuar	Inginjer Përpunim druri	Teknikë përpunim druri	Pun.kualif./ punonjës gjithsej	Ing.Përp.-druri / punonjës gjithsej	Nr. Bizneseve me Ing.druri
49	671	387	34	59	58%	5%	32

Një rol i veçantë në industrinë e përpunimit të drurit i kemi kushtuar mënyrës së punës pra në lidhje me porosinë prodhues klient. Nga intervistimet e realizuara shikojmë se rreth 82% e subjekteve ekonomike punojnë mbi bazën e

porosive të klientëve .Vetëm një subjekt ekonomik punon me material të porositësit (fason).Me kontrata paraprake të klientit punojnë rreth 29% e subjekteve ekonomike.Një pjesë tjetër e këtyre bizneseve punon në pritje të kontratave,

pra “ditë për ditë”. Kjo tregon se këto subjekte ekonomike kanë një pasiguri të madhe në jetëgjatësinë dhe sigurimin e punës. Ndër subjektet ekonomike të përfshira në pyetësor vetëm 5 subjekte punojnë për eksport, nga të cilët 4 me aktivitet elementar druri dhe 1 për prodhim mobiljesh (materjal porositësi, fason). Një rëndësi të në pyetësor ju kushtua fuqisë puntore dhe kualifikimit. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim të dhënat e 49 subjekteve ekonomike të përfshira në këtë pyetësor.


Në këtë tabelë të bie në sy përqindja e ulët e punonjësve të kualifikuar (vetëm 58%). Mund të shtonim akoma më tepër edhe numrin e pakët të teknikëve të përpunim drurit (59 teknikë gjithsej) në lidhje me numrin e punonjësve të kualifikuar (rreth 15%) që punojnë në biznesin e përpunim drurit. Shkollat profesionale të këtij profili nxjerrin shumë më tepër teknikë përpunim druri prandaj ky punësim i pakët i tyre tregon se përfitueshmëria ekonomike e tyre nuk është tërheqëse për ta.




Grafiku 1.

Tabloja për inxhinjerët e përpunim drurit është më ndryshe. Rreth 2/3 e bizneseve kanë nga një inxhinjer përpunim druri. Theksojmë se edhe ky raport duhet të jetë më i madh sepse numri i inxhinjerëve që diplomohen në Universitetin Bujqësor të Tiranës është shumë i madh dhe se kërkesat e sotme të cilësisë së produkteve të drurit të përpunuar e bëjnë të domosdoshme prezencën e inxhinjerëve të specializuar në këtë proces pune.


Duke parë aspektin e ngarkesës së punës bizneset e përpunim drurit paraqesin specifikën e tyre. Në 4 grafikët e mëposhtme (grafiku 2,3,4,5) kemi paraqitur ngarkesën e punës së bizneseve e ndarë sipas tremujorëve.



Grafiku 2.



Grafiku 3.



Grafiku 4.

Nga katër grafikët e mësipërm shikojmë se kemi 4 subjekte (grafiku (2) 8%) që nuk punojnë në tremujorin e parë. Ndërprerja e aktivitetit në këtë tremujor lidhet me faktin e mungesës së furnizimit me lëndë të parë, kryesisht lëndë të sharruar (trupa). E përgjithshme në këtë tremujor është se pothuasje të gjitha subjektet 84% (41 subjekte) punojnë me kapacitet të reduktuar.

Në tremujorin e dytë grafiku i aktivitetit të punës fillon dhe intensifikohet dhe nuk kemi subjekte pa aktivitet. Subjektet që punojnë me kapacitet të

plotë nga 8% që ishin në tremujorin e parë arrijnë në 51% në tremujorin e dytë (25 subjekte).


Në tremujorin e tretë kemi të njejtën prirje si në tremujorin e dytë. Numri i subjekteve me aktivitet të plotë është në rritje, 40 subjekte duke përbërë 83% të tyre. Ndërsa në tremujorin e katërt numri i subjekteve me aktivitet të plotë fillon të bjerë në 31 që përbën 63% të subjekteve të intervistuar.

Një rubrikë tjetër e rëndësishme është rubrika e shitjeve që realizojnë subjektet e intervistuar. Për këtë rubrikë duhet të kemi parasysh se fshehja e shifrave të vërteta është e natyrshme për shkak të problemeve me taksat që parashikon legjislacioni. Sidoqoftë një vizion të përgjithshëm mund t'a përftojme. Nga subjektet ekonomike të intervistuar tre prej tyre nuk u shprehën fare për nivelin e shitjeve duke u shprehur për frikën ndaj taksave që do të duhej t'i paguanin shtetit. Klasifikimin sipas shitjeve e kemi realizuar duke patur parasysh edhe skemën e detyrimeve që ka hartuar legjislacioni ynë në lidhje me këtë pikë. Konkretisht kemi realizuar klasifikimin: deri në 8 milion, nga 8.1 deri 25 milion, 25.1 deri 50 milion, 50.1 deri 100 milion, mbi 100 milion. Në grafikun 6 jepen rezultatet e përfutuara nga pyetësi.


Bie në sy se afro 50% e subjekteve realizojnë një xhironjetore deri në 25 milion lekë. Ndërsa deri 50 milion lekë janë afro 75% e këtyre subjekteve. Vlen të theksojmë se subjektet që prodhojnë për eksport kanë shitje mbi 50 milion lekë.

Në vendosjen e çmimit të një produkti marrin pjesë shumë faktorë, të cilët nuk po i përmendim, porse mund të themi se funksioni i çmimit është mjaft kompleks. Në grafikun 7 shikohet se vetëm 9% e subjekteve kanë konsideruar si faktorin më të rëndësishëm çmimin e konkurrencës. Subjektet që shikojnë vetëm koston e prodhimit si faktorin më të rëndësishëm janë 52% ndërsa subjektet që vlerësojnë njëkohësisht si koston e prodhimit ashtu dhe çmimin e konkurrencës përbëjnë 39% të subjekteve. Shohim se kosto e prodhimit në 91% të subjekteve është faktori përcaktues në vendosjen e çmimit të produktit. Kjo tablo e thjeshtë e faktorëve përcaktues në vendosjen e çmimit tregon se produktet e prodhuara nga kjo industri nuk janë në një shkallë përpunimi shumë


të lartë. Proceset e punës për realizimin e produktit nuk mund të konsiderohen të komplikuar.



Grafiku 5.




Grafiku 6.




Grafiku 7.

Faktorët negativë që kanë influencuar në ofertë janë përmendur: çmimi lëndës parë, konkurrenca pandershme, sigurimi lëndës parë, cilësia lëndës parë, teknologjia përdorur. Nga grafikun 8 vërejmë se 75% e subjekteve e shikojnë konkurrencën e pandershme si faktorin themelor të influencës në ofertë, ndërsa çmimi i lëndës së parë përbën 70%

të subjekteve që e konsiderojnë si faktor themelor. Me lëndën e parë lidhen edhe cilësia e cila përmendet në 63% të subjekteve si dhe sigurimi i lëndës së parë me 30% të subjekteve. Teknologjia e përdorur është ajo që i preokupon më pak këto biznese, vetëm 25% e tyre e shikojnë si faktor negativ. Nëqoftëse do të përfshinim në një zë problemet që lidhen me lëndën e parë : çmimi, cilësia, sigurimi do të shikonim se 90 % e bizneseve do ta konsideronin lëndën e parë si faktorin përcaktues që influencon negativisht në ofertë.



Grafiku 8.



Grafiku 9.

Duhet të theksojmë se të gjitha bizneset e prodhimit të mobiljeve e sigurojnë lëndën e parë kryesisht nga importi. Fakti që 70% e subjekteve pranojnë se egziston një konkurrencë e pandershme tregon se klima e këtij biznesi nuk është dhe aq e shëndetëshme. Periudha e tranzicionit kaq e zgjatur shkakton një dëm mjaft të madh ekonomik.

Ndër faktorët negativë që influencojnë në kërkesë janë përfshirë këto zëra: fuqia blerëse e kufizuar, konkurrenca paralele, konkurrenca pandershme, produktet importit, mungesa e informacionit, cilësia e produktit.

Grafiku 9 tregon perceptimin e bizneseve në lidhje me faktorët negativë në kërkesë.

Vihet re i njëjti perceptim i subjekteve të pyetura në këtë pyetësor. Konkurrenca e pandershme zë vendin kryesor me 80% të bizneseve kanë plotësuar këtë zë. Fuqia blerëse e kufizuar është e natyrshme që të jetë ndër zërat më kryesor, dhe kjo arin nivelin e 63%. Produktet e importit janë një tjetër antagonist në kërkesën për produkte të përpunim drurit që bizneset e shikojnë si një kërcënim serioz. Konkurrenca paralele dhe cilësia e produkteve të prodhuara nga subjektet e intervistuar është më pak e ndjeshme, por jo e neglizhueshme, konkurrenca paralele është në nivelin e 20% ndërsa cilësia e produktit në 18%. Konkurrenca e pandershme është një kërcënim serioz për këtë biznes, gjithashtu edhe fuqia blerëse e kufizuar tregon nivelin e ulët ekonomik të shoqërisë. Shoqëria kërkon të shpenzojë më tepër për produkte të tjera ku produktet ushqimore pa diskutim që zënë vendin e parë.

Përfundime

Industria e drurit në Shqipëri, pavarësisht zvoglimit të peshës së saj në ekonominë shqiptare në krahasim me periudhën përpara viteve '90 vazhdon të jetë një degë e rëndësishme e ekonomisë.

Kjo industri mund të konsiderohet sot tërësisht private ku dallohen dhjetra subjekte të madhësisë së mesme dhe qindra të tjera të vogla apo shumë të vogla, të cilat kryesisht zhvillojnë aktivitetin e tyre në prodhimin e mobiljeve.

Teknologjia e instaluar është relativisht e vjetër dhe proceset teknologjike në realizimin e produkteve të industrisë së përpunim drurit nuk mund të konsiderohen si procese me kompleksitet të lartë. Mosadaptimi i teknologjisë ka sjellë dhe zvogëlimin e peshës së kësaj industrie në eksportin e produkteve shqiptare, si pasojë e pamundësisë për të konkurruar me cilësinë e produkteve që prodhohen.

Ky nivel i teknologjisë si dhe paqëndrueshmëria e tregut të brendshëm bën që kapacitetet e instaluar të mos përdoren në maksimumin e tyre.

Problematikës së teknologjisë së vjetër i është shtuar në vitet e fundit vështirësia e sigurimit të lëndëve të para nga ekonomia pyjore e vendit, zhvillim i cili ka çuar në një tendencë në rritje të sigurimit të tyre përmes importit.

Niveli i kualifikimit të fuqisë punëtore, qoftë ky dhe inxhiniero-teknik është i pakënaqshëm dhe kërkon nga kompanitë, veçanërisht ato të madhësisë së mesme përpjekje më të mëdha në trajnimin e personelit.

Një problematikë tjetër është dhe konkurenca e pandershme në industrinë e përpunim drurit që tregon klimën jo të favorshme për zhvillimin e këtij biznesi.

Fuqia e ulët ekonomike dhe konkurenca e produkteve të importit përbëjnë një kërcënim serioz për këto biznese.

Literatura e përdorur

1. Ajdinaj, D., Pellerano, A. & M. Kotro (2001): Risorse forestali e industria del legno in Albania. 16 p. In: Ingegneria agraria per lo sviluppo dei paesi mediterranei. Convegno nazionale di Ingegneria Agraria. Vieste del Gargano.
2. BSPID (1996): Studim mbi gjendjen dhe zhvillimin e industrise se drurit si dhe problemet qe duhen zgjidhur ne kuadrin e privatizimit te saj. Tirane.
3. DRN & ECO-Consult (2003): Analysis of Markets & Marketing of Forest-Based Products. Study Report, f. 55-75
4. Merlo, M., Fontanivo, M., Semezin, L. & Zanetti, L. (eds.) (2001): Foreste ed industria del legno: una risorsa locale per un mercato globale. Dep.to TESAF, Facolta di Agraria e Forestale, Universita di Padova., f. 79-104.